SHQIPERIA SOCIALISTE MARSHON

Versioni elektronik i ketij libri u krijua nga
http://www.enverhoxha.ru

The electronic version of the book is created by
http://www.enverhoxha.ru

La version électronique du livre était créée par
http://www.enverhoxha.ru

SHQIPERIA SOCIALISTE MARSHON

BOTUAR ME RASTIN E 25 VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT DHE TRIUMFIT TË REVOLUCIONIT POPULLOR

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI» TIRANË 1969



VENDI KU POPULLI ËSHTË ZOT I FATEVE TË VETA

THE COUNTRY WHERE THE PEOPLE ARE THEIR OWN MASTERS

LE PAYS OU LE PEUPLE EST MAITRE DE SES DESTINEES



SHQIPËRIA, ky vend i vogël në jugperëndim të Gadishullit Ballkanik me 28.748 km². dhe 2 milion banorë, përpara çlirimit njihej si një nga vendet më të prapambetura të Evropës, me një regjim shtypës feudoborgjez, pa industri, me bujqësi të prapambetur, me 83% të popullsisë analfabete, me 60% të popullsisë të prekur nga malarja, pa folur këtu për sëmundjet e tjera shoqërore, gati pa rrugë, pa asnjë kilometër hekurudhë, me papunësi dhe uri kronike, me pasuritë kreysore të tokës dhe nëntokës në duart e kapitalit të huaj. Shkurt, një vend gjysmëkolonial, ku ligjin e bënin feudalët e borgjezët e vendit dhe fuqitë e huaja imperialiste.

Sot, Republika Popullore e Shqipërisë është një vend i lirë, i pavarur dhe sovran, ku është vendosur diktatura e proletariatit, që e ka bazën në aleancën e ngushtë të klasës punëtore me fshatarësinë dhe masat e tjera punonjëse, ku pushteti është në duart e popullit, si rezultat i Luftës Nacional-Çlirimtare që populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste (sot Partia e Punës e Shqipërisë), me shokun Enver Hoxha në krye, bëri kundër pushtuesve të huaj, fashistëve italianë e nazistëve gjermanë, dhe kundër klikave tradhëtare feudoborgjeze të vendit.

Sot, Shqipëria është një vend agraro-industrial dhe po ecën me hapa të shpejtë e të sigurtë në rrugën e shndërrimit të saj të shpejtë në një vend industrialo-agrar, me perspektivë që të kthehet në një vend industrial me një bujqësi të përparuar. Industria shqiptare, në krahasim me vitin 1938, prodhoi më 1968 52 herë më shumë, ndërsa bujqësia e ka rritur prodhimin e saj 3 herë. Analfabetizmi është zhdukur qysh në fund të vitit 1955, arësimi tetëvjeçar është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët e moshës shkollore, arësimi i mesëm dhe teknik ka marrë një zhvillim jashtëzakonisht të madh, ndërsa arësimi i lartë, që nuk ekzistonte fare në Shqipërinë e paraçlirimit, ndiqet nga mijëra bija e bij punëtorësh, fshatarësh e punonjësish të tjerë. Malarja dhe sëmundjet e tjera shoqërore janë zhdukur me kohë dhe mesatarja e jetës, që ishte më 1938 37 vjet, është rritur në 67 vjet. Niveli material

ALBANIA, a small country in the southwest of the Balkan Peninsula, has an area of 28,748 square kilometres and a population of 2 million. Prior to its liberation it used to be known as one of the most backward countries in Europe, under a feudal and bourgeois regime of oppression. It had primitive agriculture and no industry. Of its population 83% were illiterate and 60% infected with malaria, not to mention here the various contagious diseases. It had almost no highways and railways. Unemployment and hunger were chronic and the principal surface and underground resources were in the hands of foreign capital. In short, it was a semi-colonial country where the law was made by the local feudal chiefs, the bourgeoisie and the foreign imperialists.

Today, the People's Republic of Albania is a free, independent and sovereign country where the dictatorship of the proletariat is already established on the basis of the close alliance of the working class with the peasantry and the other working masses, and where the people hold the reins of state power in their own hands, thanks to the National-Liberation War the people waged under the leadership of the Communist Party (now the Party of Labour) of Albania headed by Comrade Enver Hoxha against foreign occupationists, the Italian fascists and German Nazis, as well as against the feudal-bourgeois traitorous cliques of the country.

Today, the People's Republic of Albania is an agrarian-industrial country, advancing steadily towards becoming an industrial-agrarian country and, eventually, an industrial one with advanced agriculture. In 1968, Albanian industry turned out 52 times as much as in 1938 while agriculture raised its output 3 times. Illiteracy was wiped out as far back as 1955, eighth-grade education is compulsory for all children of school age, secondary general and vocational education has made tremendous progress, while higher institutes of learning, non-existent before liberation, are being attended by thousands of sons and daughters of the workers, peasants and other working people. Malaria and other contagious diseases have long been wiped out and the

L'ALBANIE, ce petit pays montagneux (28.748 km², 2 millions d'habitants), située au sud-ouest de la péninsule des Balkans, était connue, avant la Libération, comme l'un des pays les plus arriérés d'Europe, un pays au régime d'oppression, féodal et bourgeois, un pays dépourvu d'industrie, avec une agriculture arriérée, une proportion de 83 pour cent d'illettrés et 60 pour cent de la population atteinte par la malaria, sans parler ici des différentes maladies sociales, un pays ne possédant presque pas de routes et aucune voie ferrée, caractérisé par un chômage et une disette chroniques et dont les richesses principales du sous-sol se trouvaient aux mains du capital étranger. Bref, un pays semi-colonial, où c'étaient les féodaux et les bourgeois, ainsi que les puissances étrangères impérialistes qui faisaient la loi.

Aujourd'hui, la République Populaire d'Albanie est un pays libre, indépendant et souverain, où a été établie la dictature du prolétariat, fondée sur une étroite alliance de la classe ouvrière avec la paysannerie et les autres masses travailleuses, et où le pouvoir est aux mains du peuple, ce qui est une conséquence du triomphe de la Lutte de Libération Nationale que le peuple albanais, guidé par le Parti Communiste (actuellement le Parti du Travail d'Albanie) ayant à sa tête le camarade Enver Hoxha, livra contre les occupants étrangers, les fascistes italiens et les nazis allemands, et contre les cliques traîtresses féodalo-bourgeoises du pays.

Aujourd'hui, la République Populaire d'Albanie est un pays agricole-industriel et elle avance à des rythmes rapides et avec assurance sur la voie de sa transformation accélérée en un pays industriel-agricole, avec la perspective de devenir un pays industriel à agriculture avancée. Par rapport à l'année 1938, la production de l'industrie albanaise avait augmenté, en 1968, de 52 fois, tandis que l'agriculture avait accru sa production de 3 fois. L'analphabétisme a été liquidé dès la fin de l'année 1955, l'enseignement de huit ans est devenu obligatoire pour tous les enfants d'âge scolaire, l'enseignement secondaire général et l'enseignement secondaire technique connaissent un immense essor, tandis que l'enseignement supérieur, qui n'existait point en Albanie avant la Libération, est suivi par des milliers de fils et de filles d'ouvriers, de paysans et d'autres travailleurs. La malaria et d'autres maladies sociales ont disparu depuis longtemps

e kultural i punonjësve s'ka fare të krahasuar me të kaluarën.

Po si mund të shpjegohet fakti që një vend kaq i vogël, i rrethuar dhe i lakmuar nga armiq të ndryshëm, të egër e dinakë siç janë imperialistët, revizionistët dhe shërbëtorët e tyre, të ecë përpara, të korrë fitore pas fitoresh në të gjitha fushat, të ruajë të paprekura lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin, të gëzojë një prestigj kaq të madh në arenën ndërkombëtare dhe simpatinë e thellë të popujve të tjerë duke u bërë, madje, edhe një shembull frymëzimi për ta?

Kjo shpjegohet me vijën e drejtë marksiste-leniniste që Partia e Punës e Shqipërisë, me shokun Enver Hoxha në krye, ka zbatuar qoftë në periudhën e revolucionit të armatosur, qoftë në periudhën e ndërtimit të socializmit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit socialist në të gjitha fushat e jetës. Kjo shpjegohet me faktin se populli është plotësisht zot i fateve të veta dhe se uniteti i popullit rreth Partisë është i pathyeshëm.

Natyrisht, këto fitore populli shqiptar nuk i ka arritur pa gjak e sakrifica, pa punë këmbëngulëse dhe vigjilencë të lartë revolucionare. Themelet e pushtetit popullor janë çimentuar me gjakun e 28.000 dëshmorëve, 12.600 të plagosurve të Luftës Nacional-Çlirimtare dhe të shumë të tjerëve që kanë rënë pas çlirimit, me pushkën dhe kazmën në dorë, për të mbrojtur dhe ndërtuar Shqipërinë e re socialiste. Është dashur të kapërcehen me heroizëm dhe guxim revolucionar një varg i pambaruar mungesash e pengesash të ndryshme, komplotesh e blokadash të njëpasnjëshme të imperialistëve, revizionistëve modernë dhe shërbëtorëve të tyre, është dashur të zhvillohet një luftë e gjërë dhe e thellë klasore qoftë kundër elementëve të klasave të përmbysura, qoftë kundër ideologjisë së vjetër në ndërgjegjen e njerëzve, është dashur të kapërcehen një numër i madh vështirësish të rrjedhura nga procesi i rritjes dhe i ecjes përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të revolucionit socialist. Revolucioni socialist në Shqipëri është zhvilluar dhe po zhvillohet në mënyrë të pandërprerë, duke

average span of life, which was 37 in 1938, has now been raised to 67. The present material welfare and cultural uplift of the workers are beyond comparison whatsoever with those of the past.

How can it be accounted for that so small a country, encircled and coveted by different ruthless and wily enemies like the imperialists, the modern revisionists and their lackeys, forges ahead, scoring one victory after another in all fields, safeguarding its freedom, independence and sovereignty, enjoying such high prestige in the international arena and such deep sympathy from the other peoples as to become a symbol of inspiration for them?

This is the merit solely of the correct Marxist-Leninist line the Party of Labour of Albania headed by Comrade Enver Hoxha has pursued both during the period of the armed uprising and during the subsequent period of socialist construction and further development of the socialist revolution in all the domains of life. This is to be accounted for by the unbreakable unity of the people around their Party and by the fact that the people have become masters of their own destiny.

Of course, the Albanian people have not attained these achievements without bloodshed and sacrifices, without persistent efforts and high revolutionary vigilance. The foundations of the people's power have been cemented with the blood shed by 28,000 martyrs, 12,600 wounded in the National-Liberation War and by hundreds of others who have fallen after liberation with pick in one hand and rifle in the other in order to build and defend the new socialist Albania. It has been necessary to overcome with revolutionary heroism and courage an endless chain of shortages and various obstacles, to foil the repeated plots and blockades of the imperialists, modern revisionists and their lackeys, to wage a deep-going class struggle on a broad scale both against the elements of the overthrown classes and the survivals of the old ideology in the minds of people, to cope with a large number of difficulties that crop up in the course of growth and advance on the road of socialist construction and

et la durée moyenne de la vie, qui était de 37 ans en 1938, s'est élevée à 67 ans. Quant au niveau du bien-être matériel et culturel des travailleurs, il n'est même pas question de le comparer au passé.

Comment est-il possible qu'un pays si petit, entouré et convoité par divers ennemis féroces et rusés tels que les impérialistes, les révisionnistes modernes et leurs valets, puisse aller de l'avant, remporter victoire sur victoire dans tous les domaines, sauvegarder sa liberté, son indépendance et sa souveraineté, jouir d'un si grand prestige sur le plan international et d'une sympathie si profonde de la part des autres peuples, devenant même un exemple exaltant pour eux?

Cela s'explique par la juste ligne marxiste-léniniste que le Parti du Travail d'Albanie ayant le camarade Enver Hoxha à sa tête a appliquée soit pendant la période de la révolution armée, soit au cours de la période suivante de l'édification du socialisme et du développement ultérieur de la révolution socialiste dans tous les domaines de la vie. Cela s'explique par le fait que le peuple est pleinement maître de son destin et par l'unité indestructible de notre peuple autour du Parti.

Bien entendu, le peuple albanais n'a pas remporté ces victoires sans verser son sang et sans consentir des sacrifices, sans un travail opiniâtre et sans une haute vigilance révolutionnaire. Les fondements du pouvoir populaire ont été cimentés du sang des 28.000 martyrs, des 12.600 blessés de la Lutte de Libération Nationale et de centaines d'autres qui sont tombés après la Libération, le fusil et la pioche en main, pour défendre et construire l'Albanie nouvelle, socialiste. Il a fallu surmonter avec un héroïsme et un courage révolutionnaires une série interminable de lacunes et d'obstacles divers, déjouer les complots et blocus réitérés des impérialistes, des révisionnistes modernes et de leurs suppôts, il a fallu mener une vaste et profonde lutte de classe soit contre les éléments des classes renversées, soit contre la vieille idéologie dans Ta conscience des hommes, il a fallu surmonter un grand nombre de difficultés dérivant du processus de croissance et de progrès sur la voie de l'édification du socialisme et de la révolution socialiste. La révolution socialiste s'est développée et se développe sans interruption, sous l'impulsion du Parti du Travail d'Albanie ayant à sa tête le camarade Enver Hoxha.

patur si motor lëvizës Partinë e Punës të Shqipërisë me shokun Enver Hoxha në krye.

Çdo kongres i Partisë ka sjellë gjithmonë fitore të reja në ndërtimin e socializmit dhe në zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist. Kongresi V i Partisë (nëntor 1966), pasi bëri bilancin e fitoreve të arritura, sidomos në luftën për shpartallimin e plotë të blokadës së egër të revizionistëve modernë, dhe përgjithësoi në një shkallë më të lartë përvojën revolucionare të Partisë dhe të masave të popullit, përcaktoi detyra të reja, me rëndësi të madhe historike për zhvillimin dhe thellimin e revolucionit socialist në të gjitha fushat. Thirrjeve të Partisë dhe vendimeve të Kongresit V klasa punëtore, fshatarësia dhe të gjitha masat e tjera punonjëse të vendit iu përgjigjën me një mobilizim dhe entusiazëm të paparë. Në gjithë vendin dhe në të gjithë fushat, veçanërisht në fushën e ideologjisë dhe të kulturës, shpërthyen shumë nisiativa dhe lëvizje revolucionare, të cilat e kanë çuar dhe do ta çojnë revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit në një shkallë gjithnjë e më të lartë.

Lufta politiko-ideologjike kundër burokratizmit, lëvizja për të vënë interesin e përgjithshëm mbi atë personal, lëvizja kundër paragjykimeve fetare dhe zakoneve prapanike, lëvizja për emancipimin e plotë të gruas, për revolucionin teknikoshkencor, për thellimin e udhëheqjes dhe kontrollit punëtor në të gjithë jetën e vendit etj. kanë bërë që të lindin elementë të rinj socialistë në ndërgjegjen e punonjësve, kanë ngritur akoma më lart ndërgjegjen e njerëzve, kanë zhvilluar më tej prodhimin, kulturën, shkencën, teknikën, artet, letërsinë, etj., kanë bërë që njeriu i sotëm në RP të Shqipërisë të edukohet në një shkallë akoma më të lartë me tiparet e njeriut të ri të shoqërisë socialiste dhe komuniste.

Këto lëvizje kanë bërë që masat punonjëse të zhvillojnë si kurrë ndonjëherë kritikën dhe autokritikën në të gjitha shkallët dhe drejtimet, të marrin një numër të madh nisiativash të guximshme e revolucionare për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit IV pesëvjeçar, për demokratizimin e mëtejshëm të pushtetit popullor, revolution. Socialist revolution in Albania has been developing uninterruptedly with the Party of Labour of Albania headed by Comrade Enver Hoxha as its driving power.

Every Party Congress has ushered in new victories in socialist construction and further development of the socialist revolution. The Fifth Congress of our Party (November 1966) drew the balance-sheet of the victories achieved especially in the struggle to completely break the severe blockade imposed by the modern revisionists, and summed up in a higher degree the revolutionary experience of the Party and the masses of the people. It assigned new tasks of major historic importance for the development and deepening of socialist revolution in all fields. The working class, the peasantry and all the other labouring masses of our country responded to the calls of the Party and the decisions of the Fifth Congress with unprecedented inspiration and enthusiasm. Throughout our country, in all fields of activity, especially in the domain of ideology and culture, our people made numerous proposals and launched revolutionary movements that carried to an even higher degree the revolutionization of the entire life in our country.

The political and ideological fight against bureaucracy, the movement to place general above personal interests, the movement to fight against religious prejudices and backward customs, to completely emancipate women, to carry on the technical and scientific revolution, to strengthen the supervising and leading role of the working class in the whole life of the country, and so on, have given birth to new socialist elements in the workers' consciousness, raised people's consciousness and promoted production, culture, science, technique, art, literature, etc. All this has made it possible for the people in the People's Republic of Albania to be brought up with the features of the new man of the socialist and communist society.

These movements have enabled the labouring masses to develop criticism and self-criticism in an unprecedented way, in all fields and directions, and to undertake a number of bold revolutionary initiatives for the fulfilment and over-fulfilment

Chaque congrès du Parti a toujours entraîné de nouvelles victoires dans l'édification du socialisme et dans le développement ultérieur de la révolution socialiste. Le V^e^ Congrès du Parti (novembre 1966), après avoir dressé le bilan des victoires remportées, en particulier dans la lutte visant à briser complètement le féroce blocus imposé à notre pays par les révisionnistes modernes, et après avoir généralisé à un niveau élevé l'expérience révolutionnaire du Parti et des masses du peuple, a fixé de nouvelles tâches de grande importance historique en vue de développer et d'approfondir la révolution socialiste dans tous les domaines. La paysannerie et toutes les masses travailleuses ont répondu aux appels et aux décisions du V^e^ Congrès par une mobilisation et un enthousiasme sans précédent. Dans tout le pays, et ce dans tous les domaines, en particulier dans celui de l'idéologie et de la culture, on a vu se déclencher nombre d'initiatives et de mouvements révolutionnaires qui ont porté et qui porteront la révolutionnarisation de toute la vie du pays à un degré toujours plus élevé.

La lutte politique et idéologique contre le bureaucratisme, le mouvement visant à subordonner l'intérêt personnel à l'intérêt général, les mouvements qui tendent à liquider les préjugés religieux et les coutumes rétrogrades, à réaliser la pleine émancipation de la femme, à promouvoir la révolution technique et scientifique, à accentuer encore la direction et le contrôle de la classe ouvrière sur toute la vie du pays, etc., ont donné naissance à des éléments nouveaux, socialistes, dans la conscience des travailleurs, élevé encore plus haut la conscience des hommes, développé plus avant la production, la culture, la science, la technique, les arts, la littérature, etc., de telle sorte que l'homme d'aujourd'hui dans la République Populaire d'Albanie acquière, à un degré encore plus élevé, les traits de l'homme nouveau de la société socialiste et communiste.

Ces mouvements ont permis aux masses travailleuses de pratiquer, et ce à un point jamais atteint, la critique et l'autocritique, à tous les échelons et dans tous les secteurs, et de prendre un grand nombre d'initiatives hardies et révolutionnaires en vue d'accomplir et même avec dépassement les tâches fixées par le quatrième plan quinquennal, en vue d'une démocratisation plus poussée du pouvoir populaire, de l'accroissement de la puissance défensive de la Patrie,

për rritjen e fuqisë mbrojtëse të Atdheut etj. Klasa punëtore, gjithmonë në krye të revolucionit, mori nisiativa të shumta për të arritur, dy-tre vjet përpara, treguesit kryesorë ekonomikë të planifikuar për vitin 1970, për të ngritur fabrika dhe linja të reja prodhimi me forcat e veta, për të prodhuar një varg artikujsh të rinj, që zëvendësuan mallrat e importit. Shumë punonjës të pararojës kaluan nga brigadat e tyre të përparuara në brigada të prapambetura, për t'i çuar edhe ato përpara etj. Fshatarësia e plotësoi brenda tre muajve detyrën e pesëvjeçarit për të përfunduar kolektivizimin edhe në fshatrat e zonave malore, hapi toka të reja, fshatarët me nisiativën e tyre zvogëluan oborret personate deri në 55-60% dhe numrin e bagëtive personale në masën 50%, në favor të pronës kolektive. U përhap nisiativa për të ndihmuar zhvillimin ekonomik të kooperativave malore etj. U zgjerua, u forcua dhe u vu mbi baza akoma më të shëndosha puna drejtpërdrejt në prodhim e kuadrove drejtuese dhe e punonjësve të administratës, e ushtarakëve, e arësimtarëve dhe njerëzve të artit e të kulturës, etj. Shkollë e madhe e edukimit revolucionar u bënë aksionet kombëtare dhe lokale të rinisë.

Me këto fitore dhe perspektiva të reja që i hapën vendit vendimet e rëndësishme të Kongresit V të PPSH për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit, Shqipëria socialiste ecën e sigurtë dhe e vendosur në rrugën e saj. Sot në 25-vjetorin e saj ajo qëndron më e fortë se kurrë, si kështjellë e pamposhtur e socializmit në brigjet e Adriatikut, gëzon admirimin, miqësinë dhe ndihmën e gjithë popujve revolucionarë të botës, veçanërisht të popullit vëlla kinez. Në miqësi dhe solidaritet, në radhë të parë me Kinën e madhe Popullore, të udhëhequr nga kryetari Mao Ce Dun, dhe me gjithë popujt revolucionarë të botës, populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e Punës me shokun Enver Hoxha në krye, duke mbajtur në një dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën do të çajë gjithnjë përpara drejt ndërtimit të plotë të socializmit e komunizmit.

of the tasks set by the Fourth Five-Year Plan and for the further democratization of the people's power and the strengthening of our homeland's defence capability. The working class, always in the lead of revolution, took many initiatives to reach, two or three years ahead of schedule, the principal economic targets planned for the year 1970, to build new factories and production lines by their own efforts and to produce a series of articles which used to be imported. Many model workers left, of their own free will, their advanced brigades and went to the backward ones to spur them onward. The peasants accomplished within three months the task of the Five-Year Plan for the complete collectivization of the villages in the mountainous areas and for the reclamation of virgin lands, and, with their initiative, they reduced their personal gardens to 55-60% and their personal livestock to 50% in favour of collective ownership. They took the initiative to help the mountain cooperatives develop their economy, and so on. The direct participation in production work by the leading cadres and the staff of the administration, the armymen, teachers and people working in the sectors of art and culture was broadened, strengthened and placed on a still sounder basis. Nation-wide and local mass actions became a great school of revolutionary education for the youth.

These achievements and the important decisions of the Fifth Congress of the Party of Labour of Albania to further revolutionize our country's life opened new vistas for the steady advance of socialist Albania. Today, on its 25th anniversary, it stands as an indomitable citadel of socialism on the Adriatic coast, enjoying the admiration, friendship and support of the revolutionary peoples of the world, particularly, of the fraternal Chinese people. The Albanian people, pick in one hand and rifle in the other, led by the Party of Labour headed by Comrade Enver Hoxha and sealed in friendship and solidarity, first of all, with the great People's China under the leadership of Chairman Mao Tsetung and with the revolutionary people of the world, will always forge ahead towards the complete construction of socialism and communism.


etc. La classe ouvrière, toujours à la pointe de la révolution, a pris de nombreuses initiatives pour réaliser, de deux à trois ans avant terme, les principaux indices économiques prévus par le plan pour 1970, pour construire de nouvelles fabriques et de nouvelles chaînes de fabrication par ses propres moyens, pour produire une série d'articles nouveaux qui remplaceront les marchandises importées. De nombreux travailleurs d'avant-garde sont passés de leurs brigades avancées à des brigades retardataires pour les faire rattraper les avancées. La paysannerie a réalisé dans l'espace de trois mois la tâche fixée par le plan quinquennal, consistant à achever aussi la collectivisation dans les villages des zones montagneuses, et elle a défriché des terres incultes; les paysans, de leur propre initiative, ont réduit de 55 à 60 pour cent la superficie de leurs enclos personnels et de 50 pour cent le bétail qu'ils détiennent à titre personnel au profit de la propriété collective. Entre autres initiatives, on a vu se propager celle de l'aide à apporter au développement économique des coopératives de montagnes. La participation directe au travail de production des cadres dirigeants et des travailleurs de l'administration, des militaires et des travailleurs de l'art et de la culture s'est élargie, renforcée et a été placée sur des bases encore plus solides. Les actions de la jeunesse à l'échelle nationale et locale sont devenues une grande école d'éducation révolutionnaire.

Forte de ces victoires et des perspectives nouvelles que les importantes décisions du V^{e} Congrès du Parti du Travail d'Albanie ont ouvertes au pays pour sa révolutionnarisation ultérieure, l'Albanie avance sur sa voie avec assurance et détermination. Aujourd'hui, en fêtant son 25^{e} anniversaire, elle se dresse plus forte que jamais comme une citadelle inexpugnable sur les côtes de l'Adriatique, jouissant de l'admiration, de l'amitié et de l'aide de tous les peuples révolutionnaires du monde et en particulier de celles du peuple chinois frère. Uni par des liens d'amitié et de solidarité à tous les peuples révolutionnaires du monde et en premier lieu à la grande Chine Populaire conduite par le Président Mao Tsétoung, le peuple albanais conduit par le Parti du Travail avec à sa tête le camarade Enver Hoxha, et tenant d'une main la pioche et de l'autre le fusil, ira toujours de l'avant vers l'édification intégrale du socialisme et du communisme.



Sot po hapet një faqe tjetër e historisë sonë, një faqe që është në dorën tonë ta bëjmë, po aq të lavdishme sa edhe luftën tonë kundër okupatorit dhe kjo është lufta për rindërtimin e Shqipërisë, për ngritjen e ekonomisë, për ngritjen e kulturës dhe të arësimit të popullit tonë, për ngritjen e nivelit shoqëror ekonomik dhe politik të tyre ...

Duhet të kuptojmë dhe këtu, ashtu si e kuptuam në luftën e armatosur, se për t'i kryer këto detyra, për t'i dhënë popullit tonë një jetë më të lumtur dhe më të begatëshme, duhet që populli i tërë të jetë faktori i kësaj vepre të madhe.



(Nga fjala e shokut Enver Hoxha mbajtur në Tiranë, më 28 nëndor 1944, një ditë para çlirimit të plotë të Shqipërisë).






















VEND AFISHIMI PER "FLETE RRUFE"
FLITE-RUFE
FLETE RRUFE
FLETE RRUFE
MISH PUBLIK Beral
Prem pëgjoje !
FLET-RRUFE
KOOP. AR




RROFTE P P SH DHE K Q I SAJ ME
SHOKUN ENVER HOXHA NE KRYE


KONGRESI
5 I P P SH

ZHVILLIMI I INDUSTRISË SOCIALISTE

DEVELOPMENT OF SOCIALIST INDUSTRY

LE DEVELOPPEMENT DE L'INDUSTRIE SOCIALISTE



KUSHT i domosdoshëm për ndërtimin e socializmit në Shqipëri ishte zhdukja e marrëdhënjeve të vjetra feudale e kapitaliste dhe vendosja, si në qytet ashtu dhe në fshat, e marrëdhënjeve të reja socialiste në prodhim, si dhe zhvillimi i vrullshëm i forcave prodhuese.

Në qytet, vendosja e marrëdhënjeve socialiste në prodhim u realizua nëpërmjet zhdukjes së pronës së madhe e të mesme kapitaliste dhe zëvendësimit të saj me pronën shoqërore socialiste me anën e shtetëzimit pa shpërblim, pa përdorimin e formës së kapitalizmit shtetëror. Shndërrimi i pronës private të prodhuesve të vegjël në pronë socialiste u bë me anën e bashkimit vullnetar të këtyre prodhuesve në kooperativa artizanati.

Thelbin kryesor të zhvillimit të vrullshëm të forcave prodhuese, për të nxjerrë vendin nga prapambetja e trashëguar, e përbënin industrializimi socialist dhe elektrifikimi i vendit. Kjo lejoi që të krijohet një bazë materialo-teknike krejt e re në ekonominë popullore, të zgjerohet prodhimi në vend i mallrave, të krijohen kushtet dhe për riorganizimin e bujqësisë mbi baza socialiste, që klasa punëtore të rritet dhe të forcojë pozitat e saj drejtuese në të gjitha fushat e jetës së vendit, që të ruhen, të zhvillohen më tej e të forcohen fitoret e revolucionit dhe të sigurohet ndërtimi i mëtejshëm socialist i vendit, të sigurohet zhvillimi i ekonomisë në mënyrë të pavarur dhe të arrihet një ngritje e dukshme e nivelit material e kultural të masave punonjëse.

Duhet theksuar se, edhe ajo industri e paktë që ekzistonte para çlirimit, ishte shkatërruar pothuajse krejtësisht nga pushtuesit e huaj. Kjo e vështirësonte akoma më shumë procesin e industrializimit dhe të elektrifikimit të vendit. Vështirësi të reja, akoma më të mëdha e më të ndërlikuara shkaktuan sidomos veprimtaria armiqësore, komplotet, blokadat ekonomike, presionet dhe shantazhet ushtarake e politike të imperialistëve dhe revizionistëve modernë gjatë këtyre 25 vjetëve të pushtetit popullor.

Por masat punonjëse, duke pasur në ballë të luftës klasën punëtore dhe të udhëhequra me guxim dhe urtësi nga Partia, me shokun Enver

AN indispensable condition for the socialist construction of Albania was the abolition of the old economic basis of landlords and the bourgeoisie and the establishment of new socialist relations in production in urban and rural areas as well as the vigorous development of the forces of production.

Big and medium capitalist ownership in urban areas was done away with and replaced by socialist common ownership through nationalization without compensation and by sidetracking state capitalism. The transformation of the small producers' private ownership into socialist ownership was carried out through their joining handicraft cooperatives on a voluntary basis.

Socialist industrialization and electrification of the country are essential factors for the speedy development of the forces of production and the freeing of the country from deplorable backwardness. Thus it is enabled to set up an entirely new material and technical basis in the people's economy, to expand the production of commodities at home, to prepare conditions for re-organizing agriculture along socialist lines, to swell the ranks of the working class so that its leading positions will be strengthened, to defend, further develop and consolidate the achievements of the revolution and ensure the building of socialism without interruption. It is also enabled to ensure the independent development of our economy and to raise the material and cultural life of the working people to a remarkably high level.

It should be stressed that the few industrial projects existing prior to liberation were turned to ruins by the foreign invaders. This aggravated the task of socialist industrialization and electrification of our country. Further and greater difficulties were caused by the hostile activities, plots, economic blockade, pressures and military and political blackmail applied against our country by the imperialists and modern revisionists during the 25 years of the people's power.

But the labouring masses, with the working class in the forefront and led with courage and wisdom by the Party with Comrade Enver Hoxha at the head, foil every plot and blockade and turn these from an impeding into an impelling factor in their speedy advance along the road of socialism. And it is precisely at these difficult moments

LA condition indispensable de l'édification du socialisme en Albanie était l'abolition des anciens rapports féodaux et capitalistes et l'instauration, dans les villes comme dans les campagnes, de rapports de production nouveaux, socialistes, ainsi que le développement impétueux des forces productives.

Dans les villes, pour instaurer les rapports de production socialistes, il a fallu liquider la grande et la moyenne propriété capitaliste et lui substituer la propriété commune socialiste par la voie de la nationalisation sans indemnité, et sans recourir à la forme du capitalisme d'Etat. La transformation de la propriété privée des petits producteurs en propriété socialiste s'est accomplie à travers l'union librement consentie de ces producteurs en coopératives d'artisanat.

L'élément essentiel du développement impétueux des forces productives, pour tirer le pays du retard hérité du passé, était l'industrialisation socialiste et l'électrification du pays. Cela a permis de créer une base matérielle et technique entièrement nouvelle dans l'économie populaire, de donner de l'extension à la production nationale de marchandises, de créer les conditions en vue de réorganiser l'agriculture sur des bases socialistes, d'accroître les rangs de la classe ouvrière et le renforcement de ses positions de direction dans tous les domaines de l'activité du pays, de sauvegarder, de développer plus avant et de consolider les conquêtes de la révolution et d'assurer la poursuite de l'édification socialiste du pays, de promouvoir le développement indépendant de l'économie et d'obtenir une élévation du niveau matériel et culturel des masses travailleuses.

Il convient de souligner que le peu d'industrie qui existait avant la Libération avait été quasi détruit par les occupants étrangers. Cela rendait encore plus difficile le processus d'industrialisation et d'électrification du pays. De nouvelles difficultés, encore plus considérables et complexes, furent surtout suscitées par l'activité hostile, les complots, le blocus économique, les actes de pression et de chantage militaires et politiques des impérialistes et des révisionnistes modernes au long de ces vingt-cinq années de pouvoir populaire.

Mais les masses laborieuses, fortes de l'action d'avant-garde de la classe ouvrière au combat, et conduites avec hardiesse et clairvoyance par le Parti ayant à sa tête le camarade Enver Hoxha, ont fait en sorte que tout complot et tout blocus

Hoxha në krye, bënë që çdo komplot e blokadë të asgjësohet dhe, të kthehet jo në një faktor pengues por në një faktor nxitës, për të ecur më me vrull përpara në rrugën e socializmit. Dhe pikërisht në momentet më të vështira shpërthyen nisiativa të mrekullueshme për ta çuar prodhimin përpara, për të prodhuar artikuj dhe pajisje industriale në vend, për të projektuar dhe ndërtuar edhe objekte të ndryshme industriale me forcat dhe mjetet e vendit.

Kështu, në fund të pesëvjeçarit III (1961-1965), prodhimi i përgjithshëm industrial ishte 34.8 herë më i lartë se në vitin 1938, ose 39% më i lartë se në vitin 1960. Po të merret parasysh blokada e egër imperialisto-revizioniste, sidomos gjatë viteve të planit III pesëvjeçar, kjo ishte një fitore e madhe, që hapte shtigje për fitore të reja në të ardhmen. Kongresi V i PPSH (nëntor 1966), përpunoi direktivat e planit IV pesëvjeçar (1966-1970) në frymën e thellimit të mëtejshëm të revolucionit socialist në të gjitha fushat. Këto direktiva ishin si rezultat i një diskutimi shumë të gjërë dhe revolucionar të planit të ardhshëm nga ana e masave punonjëse të të gjithë vendit. Sipas planit IV, është llogaritur që, më 1970, prodhimi industrial të rritet 50-54% në krahasim me vitin 1965, me një ritëm mesatar vjetor prej 8.7%. Prodhimi i mjeteve të prodhimit do të rritet 65-69%, kurse ai i mallrave të konsumit të gjërë 33-38%. Me ritëm më të shpejtë po zhvillohet sidomos industria kimike, mekanike, elektrike, e bakrit, e hekur-nikelit, e naftës, e qelqit, e qiramikës etj. Për herë të parë kanë filluar të prodhohen në vend metale të petëzuara, plehra azotike dhe fosfatike, lloje të ndryshme letre dhe shumë artikuj të tjerë. Pesëvjeçari IV e ka futur vendin në një fazë të re të industrializimit, në fazën e zhvillimit të industrisë së rëndë përpunuese dhe ka sjellë përmirësimin e strukturës së prodhimit industrial, fuqizimin e industrisë dhe të gjithë ekonomisë popullore, forcimin e mëtejshëm të pavarësisë së saj dhe zhvillimin me ritme më të shpejta të bujqësisë.

Kështu, Shqipëria, nga një vend i prapambetur agrar, u shndërrua shpejt, gjatë viteve të pushtetit popullor, në një vend agraro-industrial

that remarkable initiatives were taken to spur production, turning out new articles and industrial equipment at home, designing and building up various industrial projects by relying on our own efforts.

Thus, by the end of the Third Five-Year Plan period (1961-65) gross industrial output was 34.8 times as high as in 1938, or 39% higher than in 1960. If we take into account the ruthless blockade imposed on our country by the imperialists and revisionists, particularly during the period of the Third Five-Year Plan, this was a major victory which paved the way for further and greater victories. The Fifth Congress of the Party of Labour of Albania (November 1966) worked out the directives on the Fourth Five-Year Plan (1966-70) in the spirit of intensifying the socialist revolution in all fields. These directives were the result of a very wide and revolutionary discussion of the plan by the labouring masses throughout the country.

According to the plan, industrial production targets set for 1970 will be 50-54% higher than those of 1965 at an average annual rate of growth of 8.7%; the output of the means of production will increase 65-69% while that of the commodities for consumption 33-38%. In particular, the chemical, machine-making, electrical, copper, iron-nickel, oil, glass and ceramic industries will develop at a faster rate. Sheet metal, nitrate and phosphate fertilizers, various kinds of paper and a number of other articles have been produced for the first time in the country. The Fourth Five-Year Plan has advanced the country onto a new phase of industrialization, the phase of heavy industry, and has brought about an improvement in the structure of industrial production, the consolidation of industry and of the people's economy as a whole, strengthening further its independence, and the speedy development of agriculture.

Thus, from a backward agrarian country Albania has quickly turned into an agrarian-industrial one and is well on the way towards an industrial-agrarian one. With the internationalist

ont été réduits à néant et que ces menées, au lieu d'être un obstacle, ont servi au peuple albanais de stimulant pour un progrès encore plus impétueux sur la voie du socialisme. C'est précisément aux moments les plus difficiles que l'on vit se déclencher des initiatives magnifiques tendant à faire progresser la production, à produire des articles et équipements industriels dans le pays et aussi à projeter et à construire divers ouvrages industriels par les propres forces et moyens du pays.

Ainsi, à la fin du III^e^ quinquennat (1961-1965), le volume global de la production industrielle était 34,8 fois plus élevé qu'en 1938 et de 39 pour cent supérieur à celui de 1960. Compte tenu du féroce blocus impérialiste-révisionniste imposé à notre pays, surtout dans les années du troisième plan quinquennal, c'était là une grande victoire qui ouvrait la voie à de nouvelles victoires. Le V^e^ Congrès du Parti du Travail d'Albanie (novembre 1966) élabora les directives du quatrième plan quinquennal (1966-1970) dans l'esprit de l'approfondissement de la révolution socialiste dans tous les domaines. Ces directives étaient le résultat d'un débat très vaste et révolutionnaire sur le futur plan de la part des masses travailleuses de tout le pays. Le quatrième plan quinquennal prévoit, de 1965 à 1970, un accroissement de la production industrielle de 50 à 54 pour cent, à un rythme annuel moyen de 8,7 pour cent. La production des moyens de production s'accroîtra durant la même période de 65 à 69 pour cent, alors que celle des marchandises de consommation courante de 33 à 38 pour cent. Les rythmes les plus rapides de développement seront surtout enregistrés dans les industries chimique, mécanique, électrique, dans celles du cuivre, du ferro-nickel, du pétrole, du verre, de la céramique, etc. Pour la première fois on produit dans le pays des métaux laminés, des engrais azotés et phosphatés, différentes sortes de papier et de nombreux autres articles. Le IV^e^ quinquennat engage le pays dans une nouvelle phase d'industrialisation, dans la phase caractérisée par le développement de l'industrie lourde de transformation, et il assure l'amélioration de la structure de la production industrielle, le renforcement de l'industrie et de l'économie populaire dans son ensemble, la consolidation ultérieure de son indépendance, et une accélération des rythmes de développement de l'agriculture.

Ainsi donc, l'Albanie, de pays agricole arriéré qu'elle était, s'est rapidement transformée en

dhe ka hyrë me kohë në rrugën e shndërrimit të saj të shpejtë në një vend industrialo-agrar. Me ndihmën internacionaliste të Republikës Popullore të Kinës, në vitet e ardhshme, do të ndërtohen në vendin tonë një sërë objektesh industriale me rëndësi shumë të madhe për ekonominë e vendit, si p.sh. hidrocentrali i Fierzës, në Veri të Shqipërisë, me kapacitet prej 400.000 kw., kombinati metalurgjik në Elbasan, me një kapacitet prej 800.000 ton mineral hekur-nikeli në vit, rafineria për përpunimin e thellë të naftës, me një kapacitet vjetor prej 1.000.000 ton, etj., etj.

Me qëllim që forcat prodhuese të zhvillohen në mënyrë akoma më të vrullshme, gjatë viteve të fundit, Partia ka shtruar me forcë të madhe çështjen e zhvillimit të mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor dhe të kooperimit në sferën e prodhimit. Si gjithmonë, punëtorët, teknikët dhe specialistët i janë përgjigjur kësaj thirrje me një varg nisiativash të ndryshme, që kanë për bazë bashkëpunimin e ngushtë dhe krijues midis kuadrove të lartë shkencorë dhe prodhuesve direktë dhe që kanë për qëllim shtimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të prodhimit.

Realizimi dhe tejkalimi i deritanishëm i planit IV pesëvjeçar përbëjnë një garanti të patundur, se ky plan do të realizohet me sukses përpara afatit dhe do të hapë shtigje të reja për zhvillimin akoma më të vrullshëm të industrisë socialiste në Shqipëri.

aid of the People's Republic of China, there will be set up during the coming years a number of industrial works of very great importance to the economy of the country, as for instance, the Fierza Hydro-electric Power Plant in northern Albania with an installed capacity of 400,000 kw., the Metallurgic Plant in Elbasan with a capacity of 800,000 tons of iron-nickel mineral a year, an integrated oil refinery with a capacity of 1,000,000 tons a year, and so on and so forth.

In order to develop the forces of production at higher rates the Party has forcefully raised, during the recent years, the question of the further development of technological and scientific revolution and cooperation in the field of production. As always, our workers, technicians and specialists have responded to this call with a series of various initiatives relying on the close and creative cooperation between the higher scientific cadres and the direct producers with a view to further increasing and improving production.

The fulfilment and over-fulfilment so far of the Fourth Five-Year Plan are a sure guarantee for the successful accomplishment ahead of schedule of the tasks set forth by this plan. It will open new paths for still more vigorous development of socialist industry in Albania.

pays agricole-industriel et depuis longtemps elle s'est engagée sur la voie de sa prompte transformation en pays industriel-agricole. Avec l'aide internationaliste de la République Populaire de Chine, on verra construire, dans les années qui viennent, une série d'ouvrages industriels de très grande importance pour l'économie du pays. Citons, parmi tant d'autres, la Centrale hydro-électrique de Fierzë, au nord de l'Albanie, d'une capacité de 400.000 kW, le Combinat sidérurgique d'Elbasan, qui assurera le traitement de 800.000 tonnes de minerai de ferro-nickel par an, et la raffinerie de traitement complet du pétrole d'une capacité annuelle d'un million de tonnes.

Afin que les forces productives se développent encore plus fougueusement, le Parti a insisté, ces dernières années, sur la question du développement plus poussé de la révolution technique et scientifique et de la coopération dans la sphère de la production. Comme toujours, ouvriers, techniciens et spécialistes ont répondu à cet appel en prenant une série d'initiatives diverses, qui reposent sur la coopération étroite et créatrice entre les cadres supérieurs scientifiques et les producteurs, et qui ont pour but l'accroissement et l'amélioration ultérieurs de la production.

La réalisation et le dépassement déjà enregistrés des objectifs du quatrième plan quinquennal, constituent une très sûre garantie pour l'accomplissement avant terme de ce plan qui ouvrira des voies nouvelles pour un développement encore plus impétueux de l'industrie socialiste albanaise.





EL 70 16




DISCIPLINE






TEC
-1944-












ROFTE PPSH




INDIVIDI
MA I
MINE















































TE:PERVEHTSOJME SR ME THELLE DOKUMENTAT HISTORIKE TE PARTISE PUNES SHQIPTARE
DHE veprat e shfaqur Enver TE BEHEN ATO Partine dhe Forcat E POPULLIT PUNONJES





PARTIA E SHTE TRURI
DHE ZEMRA E
POPULLIT

TEPRODHOJME
ME SHUME
ME MIRE ME LIRE

229

231

220




KOMBINATI MEKANIK
TIRANE









ZHVILLIMI I BUJQËSISË SOCIALISTE

DEVELOPMENT OF SOCIALIST AGRICULTURE

LE DEVELOPPEMENT DE L'AGRICULTURE SOCIALISTE





MENJËHERË pas çlirimit të vendit Partia dhe pushteti popullor muarën masa që edhe në fshat të asgjësohej baza ekonomike e çifligarëve, të zhdukej prona private dhe të vendosej prona shoqërore socialiste. Mbeturinat e marrëdhënjeve feudale u asgjësuan me anë të reformës agrare, që përfundoi më 1947 dhe shpronësoi pa shpërblim çifligarët dhe u dha falas tokën fshatarëve të varfër. Në të njëjtën kohë u ndalua me ligj shitblerja e tokës.

Zbatimi i reformës agrare e bindi fshatarësinë se vetëm klasa punëtore dhe partia e saj, pas marrjes së pushtetit politik, janë në gjendje të kryejnë shndërrimet rrënjësore në marrëdhënjet agrare. Kjo e forcoi akoma më shumë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, forcoi pushtetin popullor që kishte në themel të tij këtë aleancë, dhe krijoi kushtet për shndërrimin gradual socialist të fshatit me anën e rrugës së kolektivizimit dhe të krijimit të kooperativave bujqësore të prodhimit.

Kolektivizimi i bujqësisë, i filluar që më 1946, u bë mbi bazën e vullnetit të lirë të fshatarësisë dhe të bindjes së saj në epërsinë e sistemit socialist të bujqësisë. Forma e vetme që u përdor për kolektivizimin ishte kooperativa bujqësore e prodhimit, e ngritur mbi bazën e pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit, të punës së përbashkët dhe të shpërndarjes vetëm sipas punës së kryer nga çdo anëtar i kooperativës. Pushteti popullor e ndihmoi zhvillimin e kooperativave duke u akorduar atyre kredira, farëra të zgjedhura, bagëti të racës, plehra kimike, kuadro bujqësorë, duke ngritur stacione të maqinave e të traktorëve, duke bërë punime të mëdha bonifikimi, etj. Vitet e para, proçesi i kolektivizimit ishte i ngadalshëm, por me krijimin e kushteve gjithnjë e më të mira ekonomike, politike, ideologjike e teknike, procesi i kolektivizimit u shpejtua dhe mori një karakter masiv sidomos gjatë viteve të pesëvjeçarit të tretë. Kështu para Kongresit V të PPSH (nëntor 1966) ishin kolektivizuar rreth 90% të tokave fushore, kodrinore e malore. Pak muaj pas këtij Kongresi nuk mbeti asnjë fshat dhe

RIGHT after the liberation of the country the Party and the people's power adopted a series of measures to do away with the economic basis of landlords, to do away with private ownership and establish socialist common ownership in the countryside as well. Thus, the survivals of feudal relations were wiped out by the Agrarian Reform Law, the application of which ended in 1947, confiscating without compensation the land of the landlords and distributing it to the landless and land-poor peasants, banning, at the same time, its sales and purchases.

The application of the Agrarian Reform Law convinced the peasants that it is only the working class and their Party that can bring about changes in agrarian relations when they have got the reins of state in their own hands. This went a long way towards further strengthening the alliance of the working class with the labouring peasantry, strengthening the people's power which bases itself on this alliance. Necessary conditions were created for a gradual socialist transformation of the countryside through collectivization, through the establishment of agricultural producers' cooperatives.

Collectivization of agriculture, begun in 1946, was effected on the basis of the free will of the peasants and of the superiority of the socialist system of agriculture. The only form resorted to for collectivization was the agricultural producers' cooperatives established on the basis of common ownership of the means of production, of collective work and of distribution of production income only according to the work done by each member of the cooperative. The people's power promoted the development of cooperatives by providing credits, selected seeds, animals of selected breeds, chemical fertilizers, agricultural cadres, by setting up machine and tractor stations, and by carrying out major drainage and irrigation schemes, and so on and so forth. The process of collectivization continued for many years. During the early years, this process was much slower, but with the ever improving economic, political, ideological and technological conditions this process speeded up and assumed a massive character especially during the Third Five-Year Plan period. Thus, prior to the Fifth Congress

AUSSITOT après la libération du pays, le Parti et le pouvoir populaire prirent des mesures en vue d'anéantir dans les campagnes également la base économique des propriétaires terriens, de liquider la propriété privée et d'établir la propriété commune, socialiste. Les vestiges des rapports féodaux furent anéantis par la mise en œuvre de la réforme agraire qui fut achevée en 1947 et qui expropria sans indemnité les propriétaires terriens et remit gratuitement la terre aux paysans pauvres, en en interdisant l'aliénation.

L'application de la réforme agraire persuada la paysannerie que seuls la classe ouvrière et son Parti, après la prise du pouvoir politique, sont à même d'accomplir des transformations radicales dans les rapports agraires. Cela renforça encore l'alliance de la classe ouvrière et de la paysannerie laborieuse, consolida le pouvoir populaire qui lui-même reposait sur cette alliance et créa les conditions requises pour la transformation socialiste graduelle des campagnes par la voie de la collectivisation, de la création des coopératives agricoles de production.

La collectivisation de l'agriculture, commencée en 1946, fut réalisée sur la base du libre consentement de la paysannerie et de sa conviction quant à la supériorité du système socialiste de l'agriculture. La forme unique qui fut mise en pratique pour la collectivisation était la coopérative agricole de production, constituée sur la base de la propriété sociale des moyens de production, du travail en commun et de la répartition du produit uniquement en fonction du travail effectué par chaque membre de la coopérative. Le pouvoir populaire aida au développement des coopératives en leur accordant des crédits, des semences sélectionnées, du bétail de race, des engrais chimiques, en leur envoyant des cadres agricoles, en mettant en place des stations de machines et de tracteurs, en exécutant de grands travaux de bonification, etc. Les premières années, le processus de collectivisation était lent, mais avec la création de conditions toujours meilleures sur le plan économique, politique, idéologique et technique, ce processus s'est accéléré et a pris un caractère de masse, surtout au cours des années du III^{e} quinquennat. Ainsi donc, avant le V^{e} Congrès du Parti du Travail d'Albanie (novembre 1966), 90 pour cent des zones plates, montueuses et montagneuses étaient déjà collectivisées. Quelques mois après ce Congrès, il ne resta plus un village ou une exploitation agricole non englobé par la

ekonomi bujqësore pa u kolektivizuar. Kjo ishte një fitore e madhe, sepse edhe në fshat u plotësua vendosja e marrëdhënjeve socialiste në prodhim.

Fermat shtetërore dhe bashkimi i tokave të fshatarëve kooperativistë në sipërfaqe të mëdha krijuan kushtet për zhvillimin e bujqësisë socialiste mbi baza moderne. Së pari, ajo pati karakter ekstensiv, por në saje të tharjes së kënetave, të ndërtimit të kanaleve kulluese e vaditëse, të sistemimeve agrare, të futjes në shkallë të gjerë të mekanikës bujqësore, të plehrave kimike, të shkencës agronomike moderne, të pregatitjes së kuadrove teknikë të lartë e të mesëm dhe sidomos të punës së madhe politike të zhvilluar nga Partia, bujqësia shqiptare vitet' e fundit ka hyrë me vendosmëri në rrugën e një bujqësie intensive. Thirrja e Kongresit V për të siguruar bukën në vend, për t'iu qepur kodrave e maleve dhe për t'i bërë ato po aq pjellore sa dhe fushat, si dhe të tjera masa revolucionare, kanë bërë që të shpërthejë një hov i madh revolucionar në masat punonjëse të fshatit e të qytetit. Me mijëra të rinj nga qyteti e nga fshatrat fushore u bashkuan me të rinjtë e me kooperativistët e fshatrave malore për të hapur toka të reja në formë tarracash, për të çuar dritën elektrike, për të bërë ndërtime të ndryshme, për të çuar kulturën dhe jetën e re në fshat. Dhjetëra kooperativa fushore dhe ferma shtetërore me inisiativën e tyre u dërguan falas kooperativave malore me dhjetëra mijë bagëti të trasha e të imëta duke treguar kështu një solidaritet të lartë revolucionar.

Kongresi V i PPSH, midis vendimeve të tjera historike për zhvillimin e gjithanshëm të vendit me ritme të shpejta, përcaktoi që zhvillimi i bujqësisë të konsiderohej si hallka më e rëndësishme për plotësimin e detyrave kryesore ekonomike të planit të katërt pesëvjeçar. Industria, më shumë se çdo herë tjetër, do të vihet në shërbim të bujqësisë. Prodhimi bujqësor gjatë këtij pesëvjeçari do të shtohet me një ritëm mesatar vjetor prej 11,5% dhe më 1970 parashikohet të jetë 71-76% më i madh se më 1965, duke siguruar

of the Party of Labour of Albania (November 1966), about 90% of the low, hilly and mountainous land had been collectivized. Following this Congress, every village and farmstead of the country joined the cooperatives. It marked a great success for the socialist relations in production to be fully established in the countryside.

The creation of state farms and combination of the plots of land of the cooperative peasants into larger areas enabled socialist agriculture to develop by up-to-date methods. At first, agriculture in Albania was done in an extensive way. But during recent years thanks to the drainage of marshes, the building of drainage and irrigation canals, the extensive use of agricultural machinery, chemical fertilizers and up-to-date agricultural technique, the training of high and medium cadres and, especially the great amount of political work done by the Party, Albanian agriculture has applied intensive farming. The call of the Fifth Congress to achieve self-sufficiency in food grains, to afforest the hills and mountains and make them as fertile as the lowlands, as well as other revolutionary measures, have given rise to the outburst of a great revolutionary drive among the labouring masses of the rural and urban regions. Thousands of young men and young women from the cities and lowland villages joined the youths of mountainous villages in transforming virgin land into terraces, realizing electrification, putting up buildings and bringing culture and a new life to the countryside. On their own initiative, tens of lowland cooperatives and state farms donated tens of thousands of sheep, goats and cattle to the mountain cooperatives, demonstrating a high revolutionary solidarity.

Among other decisions taken for the all-round development of the country at a speedy rate, the Fifth Congress of the Party of Labour of Albania stressed that the development of agriculture should be considered as the most important link in the accomplishment of the main economic tasks of the Fourth Five-Year Plan. Industry is to come to the assistance of agriculture on a larger scale than at any other time. During this period, agricultural production will increase at an average yearly rate of 11.5% and, by 1970, it is planned to be 71-76% higher than in 1965, thus reducing

collectivisation. C'était une grande victoire, parce que l'instauration des rapports de production socialistes fut ainsi achevée dans les campagnes également.

Les fermes d'Etat et les vastes superficies formées par la fusion des terres des paysans coopérés assurèrent les conditions requises pour le développement de l'agriculture socialiste sur des bases modernes. Celle-ci prit, au début, un caractère extensif, mais grâce à l'assèchement des marais, au creusement de canaux de drainage et d'irrigation, à l'aménagement des terres, à l'introduction, sur une vaste échelle, de la mécanisation, des engrais chimiques, de la science agronomique moderne, à la formation de cadres techniques supérieurs et moyens et surtout grâce au grand travail politique effectué par le Parti, l'agriculture albanaise s'est acheminée, ces dernières années, résolument sur la voie d'une agriculture intensive. L'appel du V^{e} Congrès invitant à assurer les céréales panifiables nécessaires au pays par la production nationale, à s'attaquer aux collines et aux montagnes pour les rendre aussi fertiles que les plaines, ainsi que d'autres mesures révolutionnaires, ont aussitôt déclenché un grand élan révolutionnaire parmi les masses travailleuses des campagnes et des villes. Des milliers de jeunes des villes et des villages de plaine se sont joints aux jeunes camarades et aux coopérateurs des villages de montagne pour défricher des terres incultes et les aménager en terrasses, pour installer l'éclairage électrique dans les villages, édifier des constructions diverses, apporter une culture et une vie nouvelles dans les campagnes. Des dizaines de coopératives de plaine et de fermes d'Etat ont, de leur propre initiative, envoyé à titre de don aux coopératives de montagne des dizaines de milliers de têtes de gros et de menu bétail, faisant preuve d'une haute solidarité révolutionnaire.

Entre autres décisions historiques visant au rapide essor de notre pays dans tous les domaines, le V^{e} Congrès du Parti du Travail d'Albanie a précisé que le développement de l'agriculture doit être considéré comme le maillon le plus important dans la chaîne des principales tâches économiques à accomplir pour réaliser le quatrième plan quinquennal. Plus que jamais, l'industrie se mettra au service de l'agriculture. Au cours de ce quinquennat, la production agricole augmentera à un rythme annuel moyen de 11,5 pour cent et il est prévu qu'elle sera, en 1970, de 71 à 76 pour cent

kështu zbutjen e shpërpjesëtimit midis bujqësisë dhe industrisë, ngushtimin e dallimeve midis fshatit dhe qytetit.

Sot bujqësia socialiste shqiptare ecën me hapa të shpejtë e të sigurtë në rrugën e zhvillimit dhe jeta e fshatit po bëhet çdo ditë më e pasur dhe më e lulëzuar.

the disproportion between agriculture and industry, narrowing down the gap between urban and rural areas.

Albanian socialist agriculture proceeds at present with quick and sure strides on the road of development, and life in the countryside is becoming richer and more prosperous from day to day.

plus élevée qu'en 1965, diminuant ainsi la disproportion entre l'agriculture et l'industrie, et réduisant les différences entre la ville et la campagne.

Aujourd'hui, l'agriculture socialiste albanaise avance d'un pas rapide et assuré sur la voie du développement, et la vie rurale devient tous les jours plus prospère et florissante.























































ZHVILLIMI I TRANSPORTIT DHE I NDËRLIDHJES

DEVELOPMENT OF TRANSPORT AND COMMUNICATIONS

LE DEVELOPPEMENT DES COMMUNICATIONS ET DES TELECOMMUNICATIONS





SHQIPËRIA, para çlirimit, ishte i vetmi vend në Evropë që nuk kishte hekurudhë, megjithëse, gjeografikisht ajo ndodhet në kryqëzimin e rrugëve midis Lindjes dhe Perëndimit, ishte i vetmi vend që s'kishte një flotë tregëtare megjithëse bregdeti i saj ka një gjatësi prej 472 km dhe me një pozitë gjeografikisht të favorshme për lundrime. Po të kemi parasysh faktin që ushtria naziste, gjatë tërheqjes së saj nga Shqipëria, shkatërroi një pjesë të rrugëve, të gjitha urat, portet dhe instalimet e telekomunikacionit, bashkë me minierat e qendrat industriale, atëhere do të kemi një tablo më të qartë të vështirësive të mëdha përpara të cilave u ndodh pushteti popullor qysh ditët e para të çlirimit.

Urat e rrugët e shkatërruara u rindërtuan brenda gjashtë muajve në saje të masave energjike të pushtetit popullor. Pastaj nisi ndërtimi i rrugëve të reja dhe i hekurudhave të para në Shqipëri. Në këto ndërtime një kontribut shumë të madh dha rinia heroike e vendit me punë vullnetare. Kështu, u ndërtuan p.sh. hekurudhat e para Durrës-Elbasan dhe Durrës-Tiranë e shumë rrugë automobilistike. Ndërtimi i rrugëve dhe i objekteve të tjera industriale me punën vullnetare të rinisë është bërë tanimë një traditë e lavdishme në vendin tonë.

Krahas këtyre punimeve portet u rimëkëmbën, u zgjeruan, u përmirësuan dhe u pajisën me instalime moderne shërbimi e ngarkim-shkarkimi. Ndërkohë, u krijua gradualisht edhe flota tregëtare shqiptare, u ngrit dhe një kantier detar për ndërtimin e anijeve me tonazh të vogël dhe për riparimin e anijeve të mëdha. Sot anijet e flotës tregëtare shqiptare kryejnë lundrime në shumë skela të Evropës, Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine. Flota tregëtare shqiptare do të zhvillohet akoma më shumë në të ardhmen.

Lidhjet telegrafike e telefonike janë shtuar e përmirësuar shumë. Tani çdo lokalitet dhe shumë fshatra të veçanta kanë lidhje telefonike, ndërsa lidhjet ndërkombëtare kryhen shumë në rregull dhe me mjete teknike moderne.

Rrjeti i rrugëve automobilistike është zgjeruar dhe përmirësuar shumë. Tani s'ka lokalitet të palidhur me rrugë automobilistike. Rrugët kryesore janë asfaltuar dhe asfaltohen vazhdimisht.

BEFORE liberation, Albania was the only country in Europe without a railway although, geographically, it lies at the crossroads between east and west. Albania was the only country lacking a mercantile marine although its coast line is 472 kilometres long and geographically favourable for navigation. If we take into account the fact that during their retreat from Albania the Nazi troops demolished part of the roads, blew up all bridges, port facilities and the installations of telecommunication together with the mines and industrial centres, we will have a much clearer picture of the major difficulties the people's regime had to cope with in the early days following the liberation.

Blown-up bridges and wrecked roads were rebuilt within six months thanks to the vigorous measures of the people's power. Then, there began in Albania the construction of new roads and of the first railways. Our heroic youths rendered a valuable contribution to the construction of these projects through their voluntary work. In this way the first Durres-Elbasan and Durres-Tirana railways and many highways for motor vehicles were built up. The building of roads and other industrial projects through the voluntary work of youths has now become a glorious tradition in our country.

The reconstruction, expansion and improvement of our seaports and the equipment of their wharves with up-to-date installations for service and loading and unloading of cargoes were done also at this time. Meanwhile, the Albanian mercantile marine began to be built. A dockyard was set up to build small-tonnage boats and repair big ships. Albanian mercantile ships today ply the seas and oceans sailing to many seaports of Europe, Africa, Asia and Latin America. The Albanian mercantile marine will be further developed in the days to come.

Telegraph and telephone lines have been extended and improved a lot. Now all localities and many out-of-the-way villages have telephone lines while international communications function regularly and by modem technical means.

The network of motor highways has been widened to a considerable extent. There is no locality in the country which is not linked by highways for motor vehicles. The main roads have been asphalted and are continually being asphalted.

AVANT la Libération, l'Albanie, quoique géographiquement située au carrefour des voies reliant l'Orient et l'Occident, était l'unique pays d'Europe dépourvu de voie ferrée, le seul pays n'ayant pas de marine marchande, bien que son littoral s'allonge sur 472 km et se prête à la navigation. Si l'on tient compte du fait que l'armée nazie, au cours de sa retraite d'Albanie, avait détruit une partie des routes, tous les ponts, les ports et les installations de télécommunication, ainsi que les mines et les centres industriels, on aura alors une vue plus claire des énormes difficultés que dut affronter le pouvoir populaire dès les premiers jours qui suivirent la Libération.

Grâce aux mesures énergiques prises par le pouvoir populaire, les routes et les ponts détruits furent reconstruits dans l'espace de six mois. Puis commença la construction de routes nouvelles et des premières voies ferrées d'Albanie. Par son travail bénévole, la jeunesse héroïque du pays apporta une très grande contribution à ces travaux. C'est avec son concours que furent construites notamment les premières voies ferrées Durrës-Elbasan et Durrës-Tirana et beaucoup d'autoroutes. Le travail bénévole de la jeunesse pour la construction de routes et de divers ouvrages industriels est désormais devenu une glorieuse tradition dans notre pays.

Parallèlement à ces grands travaux, les ports ont été réaménagés, agrandis, améliorés et équipés d'installations modernes de chargement et de déchargement. Entre-temps, la marine marchande albanaise fut progressivement créée et un chantier naval pour la construction de bateaux de petit tonnage et la réparation des grands navires fut mis en place. Actuellement, les navires marchands albanais relâchent dans de nombreux ports d'Europe, d'Afrique, d'Asie et d'Amérique latine. La marine marchande albanaise est appelée à se développer encore dans l'avenir.

Le réseau des communications télégraphiques et téléphoniques s'est beaucoup étendu et amélioré. Aujourd'hui, chaque localité et de nombreux villages isolés sont reliés au réseau téléphonique et les liaisons internationales sont très régulièrement assurées par des moyens techniques modernes.

Le réseau routier a pris une grande extension et s'est beaucoup amélioré. Il n'est pas aujourd'hui de localité qui ne soit desservie par une autoroute. Les routes principales sont asphaltées et d'autres routes le seront à l'avenir.

sore janë të asfaltuara dhe do të asfaltohen vazhdimisht.

Për të pasur një ide shumë a pak të saktë mbi zhvillimin e këtij sektori, mjafton të sjellim disa të dhëna: Në krahasim me vitin 1938, lëvizja e mallrave me transportin tokësor ka qenë 362 herë më e madhe dhe me transportin detar (të brendshëm e të jashtëm) 25 herë më e madhe; lëvizja e udhëtarëve (urban e interurban) është shtuar 1360 herë; zyrat postare janë shumëzuar më se katër herë, bisedimet telefonike 55 herë, numri i radiove 348 herë, etj.


Zhvillimi i vrullshëm i ekonomisë dhe i kulturës socialiste në Shqipërinë e re kërkon patjetër edhe zhvillimin e përmirësimin e pandërprerë të transporteve dhe të ndërlidhjes. Edhe kësaj detyre pushteti popullor, si kurdoherë dhe në çdo sektor, ja ka dalë dhe do t'ja dalë me sukses.

In order to have an idea of the development of this sector, it suffices to mention: In comparison with the year 1938, the transport of goods by land has increased 362 times; and that of goods by sea (internal and external) 25 times; the passengers' movement (urban and interurban) has increased 1,360 times; post offices have increased 4 times; telephone calls 55 times; the number of receivers 348 times, and so on.

The rapid development of socialist economy and culture in new Albania demands without fail the development and uninterrupted improvement of transport and means of communication. In this task, too, the people's power will score success as it has always done in all other sectors of activity.

Il suffira, pour donner une idée plus ou moins exacte du développement de ce secteur, de fournir quelques chiffres: le mouvement des marchandises en ce qui concerne le transport terrestre a été, en 1968, 362 fois plus élevé qu'en 1938, et en ce qui concerne le transport maritime (cabotage et long cours) 25 fois; le mouvement des voyageurs (urbain et interurbain) s'est accru de 1.360 fois, les bureaux de poste se sont multipliés par quatre, les conversations téléphoniques par 55, le nombre des appareils de radio par 348, etc.

Le développement impétueux de l'économie et de la culture socialistes dans l'Albanie nouvelle requiert aussi à tout prix le développement et l'amélioration continus des communications et télécommunications. Comme toujours et dans tout secteur, le pouvoir populaire s'est acquitté et s'acquittera de cette tâche avec succès.




CL 74 26




18
DR 2414


GANZ

















ARËSIMI POPULLOR

PUBLIC EDUCATION

L'ENSEIGNEMENT POPULAIRE





REGJIMET e dikurshme feudo-borgjeze si armiq të popullit ishin armiq të arësimit dhe të kulturës. Një deputet i "parlamentit" të dikurshëm, një nga feudalët më të mëdhenj të vendit, e konsideroi ekzistencën e atyre pak shkollave të mesme si "rrezik për kombin" . . . Kjo shpjegon përse para çlirimit në Shqipëri kishte vetëm 23 kopshte fëmijësh dhe këto në qytete, asnjë çerdhe, 643 shkolla fillore kryesisht në qytete, ku mund të ndiqnin mësimet më pak se 1/3 e fëmijëve në moshë shkollore, kishte vetëm 6 shkolla të mesme, 5 shkolla të arësimit të mesëm tekniko- profesional, të gjitha këto me një numër shumë të vogël nxënësish dhe me personel shumë të kufizuar, me përmbajtje dhe me programe reaksionare, asnjë shkollë të arësimit të lartë dhe 83% e popullsisë ish analfabete.

Sot, në Republikën Popullore të Shqipërisë çdo gjë ka ndryshuar rrënjësisht. Ja disa të dhëna konkrete: përveç qindra kopshteve që ka në qytete e në fshatra, sot çdo fshat ka shkollën fillore dhe arësimi i detyruar tetëvjeçar ka përfshirë pothuajse të gjithë fëmijët e vendit (meshkuj e femra). Shkollat e mesme e të arësimit të përgjithshëm kanë arritur numrin 61 në qytet e në fshat, ndërsa ato të arësimit të mesëm profesinoal 25. Pas çlirimit të Shqipërisë janë krijuar 2 institute të larta pedagogjike dyvjeçare dhe arësimi i lartë që përfshin: Universitetin Shtetëror të Tiranës, me 7 fakultete e me 20 degë, si dhe filiale në disa qytete të caktuara, Institutin e lartë bujqësor me 3 fakultete, Institutin e lartë të arteve: për artet figurative, për artin dramatik dhe për muzikën, dhe Institutin e lartë të fiskulturës. Ka kohë që në Shqipërinë e re socialiste në çdo 4 vetë një shkon në shkollë, ndërsa analfabetizmi për moshat deri 40 vjeç është zhdukur qysh në vitin 1955. Kësisoj Shqipëria është shndërruar në një nga vendet më të zhvilluara të botës në fushën e arësimit. Por rëndësi të madhe kanë në këtë mes disa anë karakteristike të arësimit shqiptar: boshti ideologjik i tij është shkenca marksiste-leniniste. Nxënësit dhe studentët, kryesisht bij punëtorësh e fshatarësh, nuk paguajnë asnjë taksë shkollore, përkundrazi, shumica e nxënësve të shkollave profesionale dhe të studentëve gëzojnë bursën e shtetit; të gjithë të diplomuarve u është garantuar

AS enemies of the people, the former feudal-bourgeois regimes were naturally opposed to education and culture. One of the deputies to the former "parliament", who was a big feudal chief of the country, considered the existence of those few secondary schools at that time as "a menace to the nation". This explains why, before liberation, there existed in Albania only 23 kindergartens, all in cities, not a single crèche, 643 primary schools mainly in cities, which only less than 1/3 of the children of school age could attend, only 6 secondary schools, 5 secondary grade technical and vocational schools, all of which were attended by a very small number of school children, with a limited number of teaching personnel and with reactionary teaching materials and programmes. There was no school of higher education, and 83% of the population were illiterate.

Today, in the People's Republic of Albania everything has radically changed. Here is some concrete evidence. In addition to hundreds of kindergartens in towns and villages, every village has its own primary school, and eighth-grade education is compulsory for almost all the children, both male and female, of the country. Secondary schools of general education in towns and villages total up to 61, while the number of secondary grade schools of vocational education has grown to 25. Since the liberation of the country, there have been set up 2 two-year pedagogical institutes, the State University of Tirana with 7 departments and 20 special courses and with branches in some cities, the Institute of Agriculture with 3 departments, the Institute of Fine Arts, specializing in sculpture, painting, drama and music, and the Institute of Physical Culture. In new socialist Albania, one in every four persons has long been attending school, while illiteracy among people under 40 years of age was wiped out as far back as 1955. Thus, Albania has become one of the most advanced countries of the world in the field of public education. But of major significance in this regard are certain aspects of Albanian public education: Marxism-Leninism is its ideological basis ; the pupils and students, coming mostly from the ranks of workers and peasants, pay no tuition fees; on the contrary, most of the students of vocational and other schools are awarded state

LES régimes passés féodalo-bourgeois, en ennemis du peuple qu'ils étaient, agissaient aussi en ennemis de l'instruction et de la culture. Un député du "Parlement" de naguère, l'un des plus grands féodaux du pays, considérait l'existence des quelques écoles secondaires d'alors comme un "danger pour la nation". . . Cela explique pourquoi avant la Libération il n'y avait en Albanie que 23 jardins d'enfants, et ce dans les villes seulement, aucune crèche, 643 écoles primaires, principalement dans les villes, où pouvaient s'instruire moins d'un tiers des enfants d'âge scolaire; il n'existait que 6 écoles secondaires, 5 écoles d'enseignement technico-professionnel secondaire, au contenu et au programme réactionnaires, n'ayant en tout qu'un nombre très réduit d'élèves et un personnel fort restreint, aucune école d'enseignement supérieur, aussi 83 pour cent de la population se composaient d'illettrés.

A l'heure actuelle, dans la République Populaire d'Albanie, tout a radicalement changé. Voici quelques données concrètes: outre les centaines de jardins d'enfants urbains et ruraux, chaque village possède sa propre école primaire, et presque tous les enfants du pays (garçons et filles) reçoivent une instruction obligatoire de huit ans. Le nombre des écoles secondaires d'enseignement général s'est élevé à 61 dans les villes et les villages, tandis que pour l'enseignement professionnel secondaire à 25. Après la libération de l'Albanie, il fut créé deux instituts pédagogiques biennaux et l'Université d'Etat de Tirana avec 7 facultés, 20 sections, et des annexes dans certaines villes, l'Institut agricole, avec 3 facultés, l'Institut des Arts comprenant peinture, sculpture, art dramatique, musique, et l'Institut de culture physique. Depuis longtemps, dans l'Albanie nouvelle, socialiste, une personne sur quatre va à l'école, et l'analphabétisme pour les personnes ne dépassant pas 40 ans a été liquidé depuis 1955. Ainsi donc, l'Albanie s'est transformée en l'un des pays les plus avancés du monde en matière d'enseignement. Mais ce qui a une grande importance ici, ce sont quelques-uns des traits caractéristiques de l'enseignement albanais: il a pour base idéologique la science marxiste-léniniste; les élèves et les étudiants, principalement fils d'ouvriers et de paysans, ne versent aucun droit d'inscription. Bien au contraire, la plupart des élèves des écoles professionnelles et des étudiants bénéficient de bourses d'Etat, et tous les diplômés sont assurés d'avoir un travail. L'enseignement en Albanie nou-

puna, etj. Shkolla në Shqipërinë e re ka ecur qysh në fillim dhe ec nëpër një rrugë revolucionare në të gjitha drejtimet.

Në kuadrin e lëvizjes së madhe të shpërthyer nga Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit, Kongresi V i PPSH (nëntor 1966) caktoi si detyrë të rëndësishme edhe revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, i cili përfshin vetë sistemin arësimor, brendinë dhe metodat e mësimit dhe të edukimit. Si problem të dorës së parë revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës përfshinte çështjen e kalitjes revolucionare politike dhe ideologjike marksiste-leniniste të rinisë, duke pasur si mbështetje orientuese trekëndshin: mësim, punë dhe mbrojtje. Që të plotësohej detyra e revolucionarizimit të shkollës, Kongresi kërkoi para së gjithash të kryhej revolucionarizimi i arësimtarëve, të cilët duhet të jenë jo vetëm mjeshtër të profesionit të tyre, por në radhë të parë njerëz politikë, luftëtarë besnikë dhe të palodhur për socializmin dhe komunizmin, me një qëndrim dhe me sjellje komuniste në jetë dhe në punë.

Detyrat që shtroi Kongresi V i Partisë dhe fjala e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, më 7 mars 1968, "Mbi revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë", patën një jehonë shumë të madhe dhe ngjallën diskutime të zjarrta midis nxënësve e studentëve, mësuesve e profesorëve, punëtorëve, fshatarëve e intelektualëve, lidhur me strukturën e shkollës, me përmbajtjen e mësimeve dhe të teksteve, lidhur me programet e me çështje të tjera që i përkasin shkollës dhe edukimit mbi bazën e tezave dhe të orientimeve që dha shoku Enver Hoxha. Nga këto diskutime dolën propozime konkrete shumë interesante.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një kërkesë objektive e së tashmes dhe e së ardhmes, sepse kjo ka të bëjë me brezin e ri, me ndërtuesit e ardhshëm të socializmit dhe të komunizmit në Shqipëri.

scholarships; work is guaranteed to every graduate. From the very start, schools in new Albania have always been pursuing a revolutionary path in every respect.

Within the framework of the major movement sparked off by the Party to further revolutionize the whole life of the country, the Fifth Congress of the Party of Labour of Albania (November 1966) defined also the further revolutionization of schools, including the school system itself, the substance and method of teaching and education, as an important task. The revolutionary political and ideological training of youth occupied an important place in the further revolutionization of our schools, which is guided by the revolutionary triangle: study, labour and defence. In order to fulfil the tasks of revolutionizing our schools, the Congress demanded, first of all, the revolutionization of teachers who should not only be masters of their profession but, first and foremost, political persons, loyal and indomitable fighters for the cause of socialism and communism, maintaining a communist stand and conduct in life and at work.

The tasks set by the Congress and Comrade Enver Hoxha's speech at the meeting of the Political Bureau of the Central Committee of the Party of Labour of Albania on March 7, 1968, entitled "On the Further Revolutionization of Our Schools", were re-echoed far and wide and aroused lively debates among pupils and students, teachers and professors, workers, peasants and intellectuals on the structure of schools, the substance of lessons and texts, on programmes and other problems concerning school and training, on the basis of the theses put forward by Comrade Enver Hoxha and the direction pointed by him. Concrete proposals of interest emerged from these discussions.

The further revolutionization of our schools is an objective necessity of the present and the future for it affects the younger generation, the future builders of socialism and communism in Albania.

velle s'est engagé, dès le début, sur une voie révolutionnaire et avance toujours sur cette voie.

Dans le cadre du grand mouvement que le Parti a déclenché pour la révolutionnarisation de toute la vie du pays, le Ve Congrès du Parti du Travail d'Albanie, qui s'est tenu en novembre 1966, a fixé comme tâche importante la révolutionnarisation de l'enseignement comme celle dans d'autres domaines, révolutionnarisation qui devait porter sur le système d'enseignement lui-même, le contenu et les méthodes d'enseignement et d'éducation. En tant que problème primordial, la révolutionnarisation ultérieure de l'enseignement englobait la question de la trempe révolutionnaire politique et idéologique de la jeunesse, fondée sur la triple orientation: étude, travail et défense. Pour assurer la réalisation de la tâche consistant à la révolutionnarisation de l'enseignement, le Congrès demanda avant tout de réaliser la révolutionnarisation des enseignants, qui doivent être non seulement de véritables maîtres dans leur profession, mais en premier lieu des hommes politiques, des combattants fidèles et inlassables de la cause du socialisme et du communisme, ayant une attitude et un comportement de communiste dans la vie et au travail.

Les tâches posées par le Ve Congrès du Parti du Travail d'Albanie et le discours prononcé par le camarade Enver Hoxha à la réunion du Bureau Politique du Comité Central du Parti du Travail d'Albanie le 7 mars 1968, sur "la révolutionnarisation ultérieure de notre enseignement", ont eu un très grand retentissement et ont suscité parmi les élèves et les étudiants, les instituteurs et les professeurs, les ouvriers, les paysans et les intellectuels, d'ardents débats sur la structure de l'école, sur le contenu des leçons et des manuels, sur les programmes et d'autres questions ayant trait à l'école et à l'éducation sur la base des thèses et des orientations formulées par le camarade Enver Hoxha. Tous ces débats ont donné naissance à des propositions concrètes fort intéressantes.

La révolutionnarisation ultérieure de l'enseignement est une nécessité objective du présent et de l'avenir, parce qu'elle concerne la jeune génération, les futurs bâtisseurs du socialisme et du communisme en Albanie.








MARKSIZEM LENINIZMIT










LICEU ARTISTIC








LAVDI
PPSH


















KULTURA

CULTURE

LA CULTURE





SHQIPËRIA është vendi i një kulture të lashtë. Edhe kur erdhën kolonët e parë grekë, ata gjetën në truallin e sotëm të Shqipërisë një kulturë shumë të zhvilluar, kulturën ilire. Ilirët, stërgjyshët e shqiptarëve të sotëm, kanë qenë mjeshtër të njohur në punimin e metaleve, ndërtimin e anijeve dhe qyteteve, në bujqësi, blegtori dhe artet e bukura. Këtë e dëshmojnë jo vetëm historianët dhe kronistët e Lashtësisë dhe të Mesjetës por edhe gjetjet e shumta arkeologjike, etnografia, folklori gojor, vallet, këngët, kostumet gjer tek armët, orenditë shtëpiake e sendet e përdorimit të përditshëm, të punuara dhe të zbukuruara me shije të madhe artistike. Shqiptari ka mbajtur pranë parmendës jo vetëm shpatën por edhe "lahutën" e vet shekullore.

Kjo pasuri e madhe shpirtërore jo vetëm u ka qëndruar sulmeve dhe shkatërrimeve të pushtuesve të huaj gjatë shekujve, por dhe i ka dhënë popullit shqiptar forca të pashtershme që të luftojë për lirinë, pavarësinë dhe nderin e tij.

Para çlirimit, regjimet shtypëse feudo-borgjeze jo vetëm që nuk interesoheshin për zhvillimin e kulturës, letërsisë dhe arteve, por bënin çmos për të penguar edhe ato nisiativa të pakta që ndërmerrnin njerëz ose grupe përparimtare të kohës. Por le t'ua lemë më mirë fjalën fakteve konkrete. Në vitin 1938, në Shqipërinë e sunduar nga feudo-borgjezia nuk kishte asnjë shtëpi, vatër ose kënd kultural, asnjë teatër. Ekzistonin vetëm 2 muzeume të vogla, 5 biblioteka, 17 salla kinemaje me 4.800 vende dhe këto në duart e privatëve spekullantë. Në vitin 1938 u botuan vetëm 61 libra me një tirazh komplesiv prej 183.000 ekzemplarësh.

Pushteti popullor i dha një rëndësi shumë të madhe zhvillimit të kulturës dhe arteve, bile disa nga formacionet artistike që filluan menjëherë nga aktiviteti ("Teatri popullor", "Ansambli artistik i ushtrisë", etj.) ishin formuar qysh në kohën e luftës nga grupet artistike që kishte çdo repart i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Sot, në Shqipëri veprojnë 35 shtëpi kulture qyteti dhe 395 shtëpi kulture fshati, 1266 vatra kulture fshati, si dhe klube e kënde të kuq në çdo qendër pune; 24 teatro dhe estrada profesioniste, Teatri i Kukllave dhe Teatri i Operas e i Baletit në Tiranë, 95 salla kinemaje të qëndrueshme me 23.700 vende, 49 muzeume dhe shtëpi muze, 29 biblioteka rrethesh

ALBANIA is a country of ancient culture. When the first Greek colonizers came to the land inhabited by the Albanians, they found there a highly developed culture — the Illyrian civilization. The Illyrians, forefathers of the Albanians, were past masters in processing metals, in ship and town building, in agriculture, livestock and dairy farming and in fine arts, too. To this bear witness not only historians and chronicle writers of ancient times and the Middle Ages but also archaeological findings, ethnography, folk arts, dances and songs, skilfully made dresses and weapons, household utensils and objects of everyday use. The Albanians have throughout their history carried their ancient "lahuta" ("lutes") side by side with their ploughs and swords.

This spiritual richness has withstood the foreign invaders' raids and destructions through centuries, inspiring the Albanian people to fight for their freedom, independence and honour.

The feudal and bourgeois regimes of oppression in pre-liberation Albania, far from being interested in the development of culture, literature and art, did their utmost to impede the few initiatives taken by progressive individuals or groups. Facts speak for themselves. In the year 1938, there was not a single home or hearth of culture, not to mention a theatre in Albania when oppressed by the feudals and the bourgeoisie. There existed only 2 small museums, 5 libraries, 17 moving picture theatres with 4,800 seats run by private owners. In the year 1938 there were published only 61 books with a circulation of 183,000 copies.

The people's power attached major importance to the development of culture and art. Some of the artistic groups that started their activity immediately after liberation ("People's Theatre", "Army's Artistic Ensemble") were formed during the Liberation War from the artistic groups of the National-Liberation Army units. Today in Albania there function 35 homes of culture in towns, 395 in the countryside, 1,266 hearths of culture in the countryside as well as clubs and red corners at every work centre; 24 professional and variety theatre troupes, a puppet theatre and opera and ballet theatre in Tirana, 95 cinema halls with 23,700 seats, 49 museums and

L'ALBANIE est un pays doté d'une antique culture. Dès l'établissement des premières colonies grecques, il existait, sur le territoire actuel de l'Albanie, une culture très développée, la culture illyrienne. Les Illyriens, ancêtres des Albanais de nos jours, ont été des maîtres renommés dans le travail des métaux, dans la construction de navires et de maisons, en agriculture, en élevage et dans les arts. En témoignent non seulement les historiens et les chroniqueurs de l'Antiquité et du Moyen Age, mais aussi de nombreuses trouvailles archéologiques, les données ethnographiques, le folklore oral, les danses, les chants, les costumes et même les armes, le mobilier et les objets d'usage courant, façonnés et ornés avec une grande finesse artistique. L'Albanais tenait près de sa charrue non seulement son épée, mais encore sa "lahuta" ou luth séculaire.

Cette grande richesse spirituelle a tenu tête aux attaques et aux ravages des envahisseurs étrangers au cours des siècles et, de plus, elle a insufflé au peuple albanais des forces inépuisables pour défendre sa liberté, son indépendance et son honneur.

Avant la Libération, les régimes féodalo-bourgeois d'oppression n'étaient nullement intéressés au développement de la culture, de la littérature et des arts, ils mettaient tout en œuvre pour entraver les quelques initiatives entreprises par les hommes et les groupes progressistes de l'époque. Mais laissons plutôt la parole aux faits concrets eux-mêmes. En 1938, dans l'Albanie dominée par la féodalo-bourgeoisie, il n'y avait aucune maison, aucun foyer ou aucun coin de la culture, aucun théâtre. Il n'y avait au total que 2 musées insignifiants, 5 bibliothèques et 17 salles de cinéma, exploitées par des spéculateurs, comptant en tout 4.800 places. En 1938, furent publiés 61 livres seulement avec un tirage global de 183.000 exemplaires.

Le pouvoir populaire a attaché une très grande importance au développement de la culture et des arts. Bien plus, les troupes artistiques qui entreprirent dès le début leur activité (à savoir le "Théâtre populaire", l'"Ensemble artistique de l'Armée" et autres) s'étaient formées dès le temps de guerre à partir des groupes artistiques constitués auprès de chaque unité de l'Armée de Libération Nationale. A l'heure actuelle, il existe en Albanie 35 maisons de la culture dans les villes et 395 maisons de la culture dans les villages, 1.266 foyers ruraux de la culture, ainsi que des clubs et des coins rouges auprès de chaque centre de travail, 24 théâtres dramatiques professionnels et de variétés, un Théâtre de marionnettes et le Théâtre de l'Opéra et des Ballets de Tirana, 95 salles de cinéma stables totalisant 23.700 places, 49

me miliona libra. Sot botohen mesatarisht në vit 3 libra për çdo njeri. Në këto shifra nuk përmenden mijëra grupe artistike amatore të teatrit, të këngëve e valleve që funksionojnë pranë shtëpive e vatrave të kulturës, klubeve, këndeve të kuq të qendrave të punës, shkollave, reparteve ushtarake, etj. Këtu nuk përmenden mijëra biblioteka pranë këtyre institucioneve, kinematë ambulante që shërbejnë në fshatrat e qendrat e punës, etj. Shteti shpenzon çdo vit shuma kolosale për zhvillimin e kulturës, të arteve dhe fiskulturës në Shqipëri.

Ajo që është karakteristike në Republikën Popullore të Shqipërisë qëndron në faktin se kultura dhe artet kanë një karakter të thellë popullor si nga brendia, ashtu dhe nga forma. Kultura, letërsia dhe artet nga pikëpamja e brendisë mbështeten në ideologjinë marksiste-leniniste, ato janë socialiste dhe shërbejnë për edukimin ideologjik, politik, kulturalartistik dhe profesional të masave të gjera punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Ato kanë një funksion shumë të lartë shoqëror, sepse ndihmojnë shoqërinë të ecë përpara në rrugn e socializmit dhe komunizmit. Ato kanë karakter të thellë popullor dhe për faktin se janë pronë e masave punonjëse, krijohen prej tyre dhe u shërbejnë atyre.

Kultura, letërsia dhe artet, pa harruar të kaluarën e popullit, por duke vlerësuar traditat e mira përparimtare të tij, pasqyrojnë jetën, punën dhe luftën e njerëzve të sotëm, që në luftë me çdo gjë prapanike, çajnë përpara drejt jetës së re. Armata e madhe e njerëzve të kulturës, letërsisë dhe arteve ka dalë nga gjiri i popullit, rron me të e prodhon për të. Një zhvillim të madh ka marrë lëvizja e amatorëve e cila përfshin me mijëra punonjës të qytetit e të fshatit nga gjiri i të cilëve kanë dalë e dalin me qindra talente të reja në të gjithë sektorët.

Çdo vit zhvillohen në Shqipëri olimpiada teatrale, festivale të këngës e të valles, hapen ekspozita pikture e skulpture, bëhen diskutime mbi vepra letrare, etj. ku marrin pjesë me mijëra shkrimtarë, aktorë, këngëtarë, rapsodë, etj. të qytetit dhe të fshatit. Kështu, p.sh., në Gjirokastër në vitin 1968, me rastin e gjashtëdhjetvjetorit të lindjes së shokut Enver Hoxha, pikërisht në qytetin e tij të lindjes, u zhvillua festivali i këngëve dhe i valleve popullore. Grupet finaliste që

house museums, 29 district libraries with millions of books. Today we publish an average of three books per capita a year. In these figures are not mentioned thousands of amateur drama, song and dance groups attached to these houses and hearths of culture, clubs and red corners at work centres, schools, military units, etc. Nor do they include thousands of libraries attached to these institutions, mobile film teams operating in villages and work centres. Our state spends colossal sums every year for the development of culture, art and physical culture.

